



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 12.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË, DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A, PËR PROGRAMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.07.2018 shqyrtoi projektligjin “*Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti s.p.a., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit*” “në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit

Në mbledhjen e komisionit prezantuan z. Erjon Luci Zëvendësministër I Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. Luljeta Dauti, Specialiste në MFE, z. Tedi Bushaj – Specialist në MFE,znj. Brikena Jazxhi– Specialist në MFE

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A. për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, për akordimin e një huaje të butë, në vlerën 5 milionë euro.

Marrëveshja financiare paraqitet në vijim të marrëveshjes qeveritare dypalëshe ratifikuar me ligjin nr.51/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për programin “Në mbështetje të arsimit dhe formimit (AFP) nëpërmjet inovacionit”.

Marrëveshja synon përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 - 2020, për të pasur një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse, që mbështetet në aftësi më të larta dhe punësim më të mirë.

Sigurimi i këtij financimi garanton mbështetjen dhe fuqizimin e dy shkollave profesionale me drejtim bujqësinë, veterinarinë, mekanikën bujqësore etj., të cilat janë shumë të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë dhe, sidomos, në rajonin ku këto shkolla kryejnë aktivitetin e tyre.

Rezultatet e pritshme nga ky projekt janë të lidhura me:

- i. Organizimin dhe zhvillimin në mënyrë të plotë të Shkollës Bujqësore multifunkionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Fier dhe përmirësimi e riorganizimi i shkollës së AFP-së në Lushnjë;
- ii. Zhvillimin dhe aplikimin e kurrikulave të AFP-së të orientuara nga tregu;
- iii. Ndërtimin marrëdhënies të qëndrueshme dhe të përshtatura sipas kushteve, ndërmjet shkollës multifunkionale të AFP-së dhe sektorit privat;
- iv. Sigurimin e koherencës me financimin e IPA II për sektorin e punësimit dhe aftësive.

Komponentët e projektit përfshijnë:

1. ngritjen e qendrave shumëfunktionale bujqësore të ekselencës (shkolla në Fier) duke menaxhuar e organizuar në mënyrë efikente edhe shkollën teknike të Lushnjës, e

rikualifikuar siç duhet në sektorin e agro-mekanikës. Ky aktivitet do të realizohet nëpërmjet këtyre nënkomponentëve:

- Rehabilitimi i infrastrukturës;
- Blerje mallrash (Pajisje & Laboratorë);
- Asistencë institucionale teknike;
- Asistencë për ministrinë e linjës.

2. zhvillimin e kurrikulave të AFP-së, të orientuara nga tregu i punës; Programi do të ndërhyjë në secilin prej tri niveleve të ofertës AFP në Shkollën e Ekselencës, me qëllim që të jetë në gjendje të adresojë të gjitha boshllëqet e identifikuar në lidhje me aftësitë në sektorin e bujqësisë dhe atë të përpunimit agro-ushqimor.
3. futjen në kuadrin e sistem dual (të dyfishtë) funksional lidhjet e qendrës shumëfunksionale me sektorin privat, sidomos në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agro-ushqimor.
4. Ndërtimin e marrëdhënieve efçente, të përshtatura specifikisht dhe të qëndrueshme.

Marrëveshja financiare ka parashikuar ka parashikuar të drejtat dhe detyrimet e palëve të marrëveshjes në kuadër të realizimit të objektivave të saj. Autoritetet shqiptare mund t'i ofrojnë institucioneve të arsimit dhe formimit profesional: grante dhe skema mikrokredie për të rinjtë sipërmarrës bujqësorë; skema të Shërbimit Kombëtar të Punësimit; akreditim për realizimin e moduleve të trajnimit; bursa; praktika profesionale të posaçme.

Ndërsa, ndërmarrjet italiane mund t'i ofrojnë shkollës AFP: trajnime ndërkombëtare; gjetje pune; binjakëzim me shkolla të tjera AFP; shkëmbim të praktikave të mira në lidhje me përfshirje për punë të nxënësve në nevojë.

Marrëveshja financiare parashikohet të rregullohet nga ligji italian dhe organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Arbitrazhi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Marrëveshja financiare është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.195, datë 4.4.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve.

5.0 Diskutimet në Komision

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit po kërkuar informacion se cilat janë garancitë që këto projektligje do të zbatohen në kohë dhe që shqiptarët do të përfitojnë nga huat apo grandet, gjithashtu pyeten për nene të veçanta të marrëveshjeve, për mënyrën e miratimit të korrikulave profesionale, me kriteret që janë ndjekur për përzgjedhjen e shkollave. Përfaqësuesit e Ministrive u dhanë sqarime pyetjeve të drejtuara duke sqaruar se për të siguruar zbatimin e marrëveshjeve do të rritet roli i strukturave të auditivit për këtë arsye po merret një asistencë për të rritur strukturat audituese.

Në lidhje me përzgjedhjen specialistët sqaruan se në përzgjedhjen e tyre është marrë si kriter profilizimi i tyre sidomos ato shkolla që kanë si profil agro-turizimin. Synimi është për ngritjen e shkollave të profilizuar për agrobiznes pas të mesmes siç ka në vendet e tjera

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është organi kompetent sipas përcaktimeve që i bën neni 81 i Kushtetutës së Shqipërisë. Projektligji shoqërohet dhe me relacionin përkatës sipas nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjes “*Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti s.p.a., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit*” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshje ndërkombëtare.” në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligji për ratifikim;

b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;

c) vendimi i miratimit në parim;

ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;

d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;

dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

